VENDIM
Nr.12, datë 4.1.2008

PËR SHPALLJEN E ZONËS EKONOMIKE NË KOPLIK, SHKODËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.9789, datë 19.7.2007 "Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen zonë ekonomike, me statusin "Park industrial", të parcelave me sipërfaqe 61 ha, pjesë e zonave kadastrale nr.2220 dhe 2221 në Koplik, Shkodër, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Shtrirja dhe kufizimet e kësaj zone përcaktohen në hartën treguese, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Në këtë zonë ekonomike do të zhvillohen veprimtari:
- prodhuese, industriale dhe agropërpunimi;
- tregtare;
- eksport-importi;
- ndihmëse.
4. Periudha e funksionimit të zonës është 35 vjet.
5. Sipërfaqja e tokës jepet me koncesion.
6. Procedurat e përzgjedhjes së zhvilluesit të zonës përcaktohen në mbështetje të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet".
7. Albinvest të shërbejë si "*One stop shop*" për licencimin e përdoruesve, në rastet kur legjislacioni përkatës e kërkon një gjë të tillë.
8. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
Zyra Qendrore e Regjistrimit te Pasurive te Paluajteshme
Zyra Vendore e Regjistrimit te Pasurive te Paluajteshme Malesi e Madhe

Adresa Koplik Mesi e Madhe **Tel. +355 211 2010** **Fax. +355 211 2010**

NR 185 **Prot** **Date** 17.05. **2007**

Vertetohet se te gjitha pasurite e paluajtshme ne pasqyren e meposhtme, te kerkuara per ndertimin e zones industriale Koplik, prane Z.V.R.P.P. Malesi e Madhe figurojne te lira dhe me pronar shtet.

NR	NUMRI PASURISE	SIPERFAQJA M2	Z.KADASTRALE	LLOJI PASURISE
1.	159	24.000.00	2220	TOKE ARE
2.	160	63.000.00	2220	TOKE ARE
3.	161	87.000.00	2220	TOKE ARE
4.	162+164+173	39.500.00	2220	TOKE ARE
5.	163	30.000.00	2220	TOKE ARE
6.	165	17.000.00	2220	TOKE ARE
7.	168	25.000.00	2220	TOKE ARE
8.	175	5.000.00	2220	TOKE ARE
9.	176	13.000.00	2220	TOKE ARE
10.	177	14.000.00	2220	TOKE ARE
11.	178	15.000.00	2220	TOKE ARE
12.	185/2	128.000.00	2220	TOKE ARE
13.	187	56.000.00	2220	TOKE ARE
14.	192	57.000.00	2220	TOKE ARE
15.	193	27.000.00	2220	TOKE ARE
16.	194	21.000.00	2220	TOKE ARE
17.	195/1	49.321.00	2220	TOKE ARE
18.	200	13.000.00	2220	TOKE ARE
19.	201	18.243.00	2220	TOKE ARE
20.	202/1	3.000.00	2220	TOKE ARE
21.	202/2	16.500.00	2220	TOKE ARE
22.	388	128.394.00	2221	TOKE ARE

V.O. Siperfaqja 8000 m2 e pasurise 201 dhe siperfaqja 2000 m2 e pasurise 202/1 rezultojne te zena me pronare dhe kjo siperfaqe nuk eshte e pasqyruar ne tabelen e mesiperme.

REPUBLIKA E SHQIPERISE - ZYRA QENDRORE E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME - Z.V.R.P.P. MALESI E MADHE

REGJISTRUESE

Odeta RAMAJ

HARTA TREGUESE E SIPËRFAQES SË ZONËS EKONOMIKE PËR NDËRTIMIN E ZONËS INDUSTRIALE KOPLIK-SHKODËR

SIP.61 HA SHKALLA 1:400



Kufiri i parcelave kadastrale

Kufiri i siperfaqes prej 61 Ha per ndertimin e zones ekonomike Koplik - Shkoder

Largesia e kufirit te siperfaqes nga rruga nacionale 50 metra